


Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Në këtë kapitull do të interpretojmë grafikë dhe do të përpiqemi të kuptojmë logjikën e ndërtimit të tyre. Për shembull, grafiku në të djathtë tregon sa para janë grumbulluar në larjet e makinave organizuar nga këshilli i studentëve.

Ja disa mënyra se si mund të interpretohet grafiku, për të mësuar më tej në lidhje me atë që ka ndodhur:

- Sa para u mbledhën më shumë në vitin 2004, në krahasim me vitin 2003?
- Gjatë cilit prej të dy viteve pati një ulje të sasisë së parave të mbledhura?



Shumë grafikë paraqitin marrëdhënie matematike, të cilat mund t'i shprehim edhe me ekuacione ose formula. Do të njihemi me format e grafikëve që paraqitin marrëdhënie përsëritëse, vijore dhe kuadratike, si dhe marrëdhënie eksponenciale, të cilat tregojnë situata ku një madhësi shumëzohet në mënyrë të përsëritur me një numër më të madh se 1.

Fjalor Dy terma me të cilat do të njihemi gjatë këtij kapitulli:

grafik vijor

i anasjellti shumëzor

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Mund ta ndihmoni nxënësin të gjejë se ç'histori fshihet pas një grafiku, duke diskutuar me të grafikë që keni gjetur në revista, gazeta, seli në Web ose reklama. Përpiquni të merrni vesh ç'histori paraqitet në grafik, duke bërë pyetje të tilla si:

- Çfarë tregon ky grafik?
- Çfarë përfaqëson secila pikë?
- Ka ndonjë krahasim midis objekteve në grafik?
- Mund ta përdorni grafikun për të parashikuar diçka që nuk tregohet në grafik drejtpërdrejt?

Duke u përpjekur të merrni me mend historinë që fshihet pas një grafiku mund të zbavitni edhe ju edhe nxënësi juaj!